



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "DAAKONN Sh.P.K." të datës 27.10.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Largimi, trajtimi dhe deponimi i materialeve të rrezikshme në Kryeqytet" me nr. të prokurimit 616-25-6217-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "DAAKONN Sh.P.K." të datës 27.10.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Largimi, trajtimi dhe deponimi i materialeve të rrezikshme në Kryeqytet" me nr. të prokurimit 616-25-6217-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "DAAKONN Sh.P.K." (tutje "parashtruesi") me datë 27.10.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Largimi, trajtimi dhe deponimi i materialeve të rrezikshme në Kryeqytet" me nr. të prokurimit 616-25-6217-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritot (*in meritum*) të kërkesës.

obligim ligjor të kërkojë sqarim dhe/ose dokumentacion shitesë përpara se të merrte vendim për eliminim.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur marrëveshjen për shfrytëzimin e pajisjeve, megjithëse dokumentet dëshmuuese të pajisjeve (faturat, librezat teknike, certifikatat e pronësisë ose qiradhënies) janë prezantuar brenda dosjes së ofertës.

Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar për arsyt si në vijim:

Ju si OE-ik me oferte financiare me çmim prej: **49,604.00 EUR** EUR, Komisioni pas shqyrtimit, analizimit dhe krahasimit të ofertës me kërkesat e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, konstaton se ky operator nuk është i përgjegjshëm:

1. Nuk është dëshmuar përmbushja e kërkesës për kontrata të përfunduara të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit me vlerë jo më pak se 75,000.00 EUR. Është paraqitur kontratë aktive dhe jo e përfunduar, prandaj oferta është e papërgjegjshme për këtë pikë.
2. Nuk është paraqitur leje/pëlqim mjedisor për azbest, siç kërkohej sipas Aneksit 1.
3. Nuk është ofruar dëshmi për posedimin e ISO 17025.
4. Nuk është paraqitur marrëveshje valide me laborator të akredituar për analizë të azbestit (metoda NIOSH 9002), si dhe mungon licenca dhe certifikata ISO 17025.
5. Për kërkesën për makineri dhe pajisje teknike, nuk është paraqitur marrëveshje për shfrytëzimin e mjeteve, ndërsa janë dorëzuar vetëm dokumente të OE-ve të tjera pa marrëveshje për projektin në fjalë.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që arsyt e evidentuara nga komisioni vlerësues për eliminimin e parashtruesit si të papërgjegjshëm janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme. Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 03.11.2025



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Page 3 nga 3